

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. EDMOND HYKA

12/20/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 19.12.2019 për subjektin e rivlerësimit, Edmond Hyka, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 20.12.2019, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Hyka, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Xhensila Pine, z. Olsi Kocimici relator, znj. Brunilda Bekteshi anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.